



Aplikim për vizë me qëllim punësimi të pavarur

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit. Si pasojë do të nevojitet rezervimi i një date të re aplikimi përfshirë periudhat përkatëse të pritjes.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Në varësi të Zyrës së të Huajve përgjigja mund të zgjasë deri në tre muaj. Ndaj lutemi që të aplikoni për vizë në kohën e duhur, sikundër edhe për për mirëkuptimin Tuaj që brenda 12 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:

1.	Formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, 2 copë , të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.
2.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhet kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75,00 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	Fotografi pashaporte	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografimin e tretë silleni me vete si element të veçantë.
Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, me 2 fotokopje, në momentin e aplikimit		
4.	Pashaporta e udhëtimit	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
5.	Plan biznesi	Në origjinal: përshkrim i strukturuar dhe i detajuar i idesë së biznesit, i cili duhet të përmbajë pikat e mëposhtme dhe të shoqërohet nga dëshmitë përkatëse: <ul style="list-style-type: none"> • Plani për kapitalin e nevojshëm dhe plani i financimit • Prezantim i profilit të firmës • Strategjia e marketingut • Fitimet e pritshme

		<ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna rreth numrit të pritshëm të vendeve të punës dhe / ose vendeve të praktikës • Sqarim rreth ndikimit eventual pozitiv të projektit në fushat e inovacionit dhe kërkimeve shkencore
6.	Jetëshkrimi	Në origjinal – Jetëshkrimi duhet të hedhë një vështrim në jetën dhe përvojat profesionale.
7.	Dëshmi kualifikimi	p.sh. diploma, certifikata, librezë pune, dëshmi gjuhësh të huaja. (Udhëzim: Çertifikatat shqiptare duhet të jenë të pajisura me vulë apostile dhe të përkthyer në gjermanisht)
8.	Ofertë për siguracion shëndetësor	Prej ofertës së paraqitur duhet të rezultojë në mënyrë të qartë se siguracioni mbulon qëndrimin në Gjermani për qëllime pune. Për aplikues mbi moshën 45 vjec duhet edhe dëshmi e sigurimeve të pensionit.

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen nga Ambasada dokumenta të caktuara të përmendura më sipër.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.